

PUSHTETI I KATËRT



MEDIA

TË GJITHË TË BARABARTË

ALBIONA (14), LORENT (14), ANDI (14), VALDRIN (14)



Jemi të barabartë, sepse jetojmë në demokraci

Ne jemi nxënësit e klasës së IX-të nga komuna e Obiliqit. Që shumë kohë më parë, jemi të interesuar të dijmë se çfarë është demokracia. Edhe pse kemi mësuar në shkollë se cili është kuptimi i fjalës demokraci, ne donim që të mësonim edhe më shumë për të. Andaj, për herë të parë këtu në „Demos-ti“, kishim mundësinë që të zgjerojmë diapazonin e dijes rreth vlerave demokratike. E themi këtë, sepse mësuam çfarë do të thotë të jetosh në bazë të këtyre vlerave që



Jam shumë i lumtur, sepse kam shumë të drejta

i japin fuqi sistemit demokratik të qeverisjes. Demokracia brenda vetes, si vlera përfshin: barazinë, lirinë, respektin, tolerancën, solidaritetin, etj. Të jetosh në bazë të këtyre elementeve ose vlerave do të thotë të gëzosh shumë të drejta, që jo çdo sistem tjetër qeverisës i ofron. Edhe shteti ynë Kosova, që 11 vjet gëzon këtë sistem të qeverisjes. Kjo nënkupton

se neve qytetarëve nuk na cenohet asnjë e drejtë dhe të gjithë trajtohemi në mënyrë të barabartë. Shembull të tillë kemi edhe ne në shkollë. Brenda objektit shkollor, ekziston një klasë e veçantë për nxënësit me nevoja të veçanta. Këta nxënës kanë qasje në mësim dhe aktivitete, njësoj sikurse të gjithë të tjerët. Kjo dëshmon frymën demokratike, që është e pranishme në shkollën tonë. Po ashtu, këta nxënës kanë respekt nga të gjithë nxënësit e tjerë dhe të gjithë tregohemi solidarë me ta. Kjo vie, sepse demokracia promovon gjithëpërfshirjen dhe diversitetin.

Që nga shfaqja e demokracisë e deri më tash ka pasur ndryshime të mëdha, për sa i përket zbatimit të vlerave të demokracisë. Me këtë kuptojmë se çdoherë e më shumë është duke u punuar që niveli i demokracisë të ngritet dukshëm.

Prandaj, lexues të dashur, shpresojmë se e keni kuptuar vlerën e demokracisë. Çdo kontribut i juaji është i mirëseardhur në ndërtimin e mëtutjeshëm të saj.



Jemi shumë kureshtarë të mësojmë për demokracinë

QYTETARËT AKTIV BËJNË MREKULLI


ARDIONIT (15), FATLUM (14), BLEON (14), ANJESA (14)

Shkolla jonë është e njohur për iniciativa të ndryshme pro qytetarisë aktive. Ne çdo herë mundohemi që të jemi model i qytetarëve aktiv. Se si e bëjmë këtë, lexoni shembujt në vazhdim

Si grup i gjelbër, ne kemi marrë iniciativë ta pastrojmë ambientin e shkollës dhe atë të qytetit tonë. Si respektues të ligjit, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, brenda një dite, ne kemi rregulluar komunikacionin rrugor. Si zbatues të elementeve të demokracisë, e sidomos për hir të solidaritetit, ne kemi mbledhur rroba për t'i dërguar tek Kryqi i Kuq, në mënyrë që t'iu ndihmojmë njerëzve në nevojë. Për t'i aktivizuar dhe argëtuar të tjerët, kemi organizuar aktivitete të ndryshme sportive. Po ashtu, meqenëse komuna e Obiliqit është e ndotur nga termocentralet, ne kemi promovuar përdorimin e biçikletave, që të ruajmë më shumë ambientin. Për t'i parë aktivitetet që i kemi bërë ne, iu ftojmë t'i shikoni vizatimet e mëposhtme.



Qytetarët aktiv i shpërndajnë njohuritë e mësuara



Gjithmonë ekziston një iniciator për të pastruar ambientin

Shpërndarja e rrobave për të tjerët




Mbeturinat duhet të hedhen në vendin e duhur



Qytetaria aktive, përgjegjësia që e ndiejmë për vendin tonë

BRENDA KATËR MUREVE TË KUVENDIT

ALOR (15), AULON (14), AGRON (15), BLINERA (14), SHKURTA (15), DEA (14), ARBEN (14)



Të qenurit gazetar të bën të ndihesh më i lirë për gjërat që ke vendosur të thuash prej kohësh. Pikërisht këtë e realizuam ne sot

Shpeshherë të shprehurit tim me njerëz në shoqëri lidhur me Kuvendin e Kosovës apo mënyrën e qeverisjes së tij, duke mos harruar njëkohësisht përzgjedhjen e tij, bënte që shumë individë të mos pajtoheshin me mendimet që unë parashtroja. Ç'është e vërteta, Kuvendi i Kosovës është mjaft i drejtë lidhur me përzgjedhjen e personave dhe vendimeve që i merr.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës parasheh prezencën e komuniteteve jo shumicë në ulëset e deputetëve për të përmbushur kështu numrin e deputetëve të Kuvendit të Kosovës, i cili arrin në shifrën 120. Kjo është pasqyrë e reflektimit të tyre mbi barazinë gjinore, fetare dhe kryesisht barazinë e komuniteteve të ndryshme etnike. Për sa i përket barazisë gjinore, 30% e deputetëve duhet të jenë gra. Fundja, dora e një nje-

riu në fushat e ndryshme të jetës nuk është asnjëherë e mjaftueshme. Por, vendimet e Kuvendit të Kosovës nuk kanë vlerë nëse nuk zbatohen nga qytetarët e vendit tonë, Kosovës. Ndërkaq, kërkesat janë pjesë e jetës dhe si të tilla duhet të parashtrohen në institucionet përkatëse. Ne si qytetarë të komunës së Obiliqit, kemi një kërkesë për Kuvendin e Kosovës. Ne dëshirojmë të propozojmë një ligj, i cili nëse do të miratohej në Kuvendin e Kosovës, do të rregullonte çështjen e tymtarëve të termocentraleve „Kosova A“ dhe „Kosova B“. Siç e dini, këto termocentrale edhe pse na mundësojnë furnizimin me energji elektrike, njëkohësisht dëmtojnë rëndë shëndetin tonë. Konkretisht, ajo çfarë kërkojmë ne është instalimi i filterave të teknologjisë së fundit për pastrimin e tymit që del nga termocentralet e lartcekura.

Ne e dimë se institucioni i duhur, ku kjo kërkesë duhet të parashtrohet me shpresën se do të gjejmë aprovimin e saj është Kuvendi i Kosovës. Ky institucion zgjedhet nga populli, dhe populli i Kosovës duhet dhe meriton të përfaqësohet në mënyrën më të mirë të mundshme. Edhe pse, pjesa më e madhe e popullsisë ka të drejtë vote, një pjesë e konsiderueshme nuk e shfrytëzojnë këtë mundësi. Duke pasur parasysh Kosovën si shtet i ri në Evropë, përbindja e popullsisë pjesëmarrëse në zgjedhje është shumë më e ulët sesa ajo që ne dëshirojmë të jetë. Prandaj, iu bëjmë thirrje të shfrytëzoni të drejtën tuaj për votim, si qytetarë të Kosovës për një vend më të mirë.



Gazetarët që sot shkruan lirshëm

MEDIA SHUAN KURESHTJEN TONË

VALDRIN (14), ERONA (14), ELMEDIN (15), DETE (14), BLERON (15), MIRJETA (15), DIARD (14)



Media, pjesë e pandashme e jona


Ne si qenie njerëzore, jemi shumë kureshtarë dhe kemi nevojë çdo herë, të marrim informata të reja. Këto informata, ne mund t'i marrim në mënyra të ndryshme, varësisht nga ajo se çka ne kërkojmë.

Për shembull ne si klasë e IX-të, muajin që shkoi vendosëm të shkonim në Brezovicë për skijim. Por, para se të shkonim, ne morëm informata lidhur me motin, se a do të jetë i përshtatshëm për ne, a do të ketë borë të mjaftueshme, apo do të ishte e pamundur të skijojmë. Si përfundim, ne morëm atë që dëshironim dhe shkuan në Brezovicë, sepse kishte mjaftueshëm borë dhe temperaturat ishin të ulëta.

Ja një shembull tjetër. Në Kosovë kemi shumë të rinjë, të cilët përfundojnë studimet dhe janë në kërkim të punës ideale. Për të gjetur punë, ata duhet të kërkojnë konkurse në ndërmarrje, kompani të ndryshme apo

edhe organizata, varësisht nga ajo se çka ata qytetarë kanë studiuar. Pas një pune të madhe, vie shpërblimi. Pra, pas atyre studimeve të gjata, studentët duhet të punësohen. Kërkimin e punës na e ka lehtësuar shumë interneti, ku përmes rrjeteve sociale, ne kuptojmë se cilat kompani, ndërmarrje, etj., ka hapur konkurse për vende të lira pune.

Nga shembujt të cilët i paraqitëm më lart, ne theksuam se media ka një rëndësi shumë të madhe për të gjithë. Media është burim informacioni, në bazë të së cilës ne mund të kuptojmë se çfarë ndodh në çdo cep të botës. Kemi media të shkruara dhe elektronike. Në të shkruar bëjnë pjesë: gazetatat, revistat, fletushkat, kartëvizitat, etj. Ndërsa, ato elektronike janë: telefoni, TV, radio, rrjetet sociale, etj. Ne besojmë se prej artikullit tonë, keni marrë informacione të mjaftueshme dhe këto informata do t'iu shërbejnë në jetën tuaj.



Rrjetet sociale janë pjesë e medias elektronike



Gazetarë të ndershëm që japin informata të sakta



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Ibrahim Rugova“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: IX-3
Website: www.demos-ti.org Vendi: Obiliq